

**Rezultate të Programit të Punës me temë: *Për eksplorimin, identifikimin dhe koleksionimin e mostrave të farës së kultivarëve lokal dhe të afërme të egër të bimëve bujqësore, për pasurimin e fondit në Bankën Gjenetike Kombëtare* ” të realizuar në zonën e Librazhdit në periudhën Tetor – Dhjetor 2024.**

Qëllimi i këtij programi ishte vazhdimi i punës së kryer në dy misionet e fundit eksploruese të periudhës së viteve 2022 - 2023, me organizimin e ekspeditave në terren për të bërë eksplorimin dhe koleksionimin e kultivarëve tradicional lokal (landrace), të afërme të egër të rrezikuar si dhe bimët medicinale aromatike të cilat rriten në disa fshatra të rajonit lindor të vendit (bashkia Librazhd si dhe ato në kufi me zonën e bashkisë së Bulqizës).

Gjatë implementimit të programit në terren u synua që të arrihen të eksploroohen vende, fshatra e zona me rrezik të lartë erozioni gjenetik, brenda rajonit të paracaktuar.

Programi u realizua në 4 njësi administrative, ku 3 prej tyre i përkisnin Bashkisë Librazhd (Nj. A. Steblevë, Librazhd Qendër dhe Orenjë) dhe një i përkiste Bashkisë Bulqizë (Nj.A. Trebisht). Procesi i eksplorimit dhe koleksionimit u krye në 35 fshatra kurse material identifikua, rregjistrua dhe koleksionua vetëm nga 17 fshatra. Numri total i aksioneve të rregjistruar ishte 90 aksione ndërsa aksione të koleksionuara ishin 41. Këto të fundit i përkisnin kryesisht kulturave njëvjecare. Shpërndarja sipas njësive administrative e aksioneve ishte Nj.A. Steblevë = 14 aksione, Nj.A Librazhd Qendër =41 aksione, Nj.A. Trebisht= 13 aksione, dhe Nj.A Orenjë =18 aksione (Tab. 1).

Programi i punës mundësoi sigurimin e të dhënave i cili përfshin koleksionim /rregjistrim për bimët me farë për 25 specie, ku nga këto rezultuan: Perime (7 specie): fasule, bamje, spec, kastravec, domate, pras dhe kungull; Drithëra (1 specie): misër; Pemë frutore (12 specie): mollë, man, dardhë, ftua, kumbull, rrush, arrë, fik, qersh, thanë, shegë, gështenjë; Bimë medicinale (5 specie): Specie të ndryshme me rëndësi për përdorime tradicionale (Tab. 2).

Perimet dominuan me rreth 30% të aksioneve të koleksionuara, ndërsa bishtajoret me *Ph. vulgaris* (fasule e zakonshme) përbënin 19% të aksioneve që shfaqnin dhe diversitetin më të madh (17 aksione). Drithërat ishin të përfaqësuara vetëm nga kultura e misrit me 5 aksione, të cilat premtojnë interes pas vlerësimit të mëtejshëm. Pemët frutore përfshinin 12 specie, me një numër të kufizuar individësh (1-3) për popullatë. Llojet më të përhapura ishin mollët, dardhat, kumbullat dhe arrat.

Ky eksplorim pati një rëndësi të veçantë në adresimin e humbjes së varieteteve tradicionale autoktone të bimëve, një proces shqetësues që po ndikon në biodiversitetin gjenetik të zonave rurale. Rezultatet e arritura ndihmojnë në dokumentimin dhe ruajtjen e këtyre pasurive unike, duke siguruar një bazë të fortë për mbrojtjen dhe përdorimin e tyre të qëndrueshëm në të ardhmen.

Tabela 1. Shpërndarja e aksioneve të rregjistruar sipas njësive administrative

Nr. i ekspeditës	Nj.A.	Nr. i aksioneve (acc) të rregjistruar	Nr. i aksioneve (acc) të koleksionuar
I	Stebleve	14	4
II	Librazhd Qender	41	22
III	Trebisht	13	3

IV	Orenje	18	8
V (I+II+III)	Koleksionim	4	4
	<b>Total</b>	<b>90 aksesione</b>	<b>41 aksesione</b>


Lista totale e aksesioneve të regjistruara (përfshirë dhe ato të koleksionuara) jepet në tabelën me poshtë.

*Tabela 2: Lista e specieve dhe numri i aksesioneve të secilës specie të regjistruar*

Nr.	Emërtimi	Specia	Emërtimi latinisht	Numri i aksesioneve të koleksionuar / rregjistruar
1	Fasule	Common bean	<i>Phaseolus vulgaris L.</i>	17
2	Bamje	Okra	<i>Abelmoschus esculentus (L.)</i>	2
3	Spec	Pepper	<i>Capsicum annuum</i>	4
4	Kastravec	Cucumber	<i>Cucumis sativus L.</i>	5
5	Domate	Tomato	<i>Solanum lycopersicum L.</i>	4
6	Pras	Leek	<i>Allium porum L.</i>	1
7	Kungull	Autumn Squash	<i>Cucurbita pepo L.</i>	2
8	Misër	Corn	<i>Zea mays L.</i>	5
9	Mollë	Apple	<i>Malus domestica</i>	12
10	Man	Mulberry	<i>Morus alba</i>	1
11	Dardhë	Pear	<i>Pyrus communis</i>	6
12	Ftua	Quince	<i>Cydonia oblonga</i>	1
13	Kumbull	Plum	<i>Prunus domestica</i>	5
14	Rrush	Grapes	<i>Vitis vinifera</i>	4
15	Arrë	Nuts	<i>Juglans regia</i>	7
16	Fik	Fig	<i>Ficus carica</i>	1
17	Qersh	Cherry	<i>Prunus cerasus/ Cerasus avium</i>	4
18	Thanë	Cornel	<i>Cornus mass L.</i>	1
19	Shegë	Pomegranate	<i>Punica granatum</i>	1
20	Geshtenja	Chestnuts	<i>Castanea sativa L.</i>	2
21	Agulice	Primrose	<i>Primula veris L.</i>	1
22	Mjeder	Raspberry	<i>Rubus idaeus L.</i>	1
23	Dëllinja	Juniper	<i>Juniperus oxycedrus</i>	1
24	Trendafil i egër	ëild rose	<i>Rosa canina</i>	1

25	Murrizi	Haëthorn	<i>Crataegus monogina</i>	1
			<b>TOTALI</b>	<b>90 AKSESIONE</b>

Harta e e përgjithshme shpërndarjes së aksesioneve dominante në 4 NJ.A. të Librazhdit



Disa nga aksesionet e koleksionuar/rregjistruar në zonën e studimit



*Juglans regia*  
(Borovë)



*Capsicum annum*  
( Borovë)



*Zea mays L.*  
(Fushë Studen)



*Phaseolus vulgaris L.*  
(Borovë)



*Abelmoschus esculentus (L.)*  
(Qarrishtë)



*Cucumis sativus L.*  
(Gizavesh)



*Primula veris L.*  
(Letëm)



*Rubus idaeus L.*  
(Qarrishtë)



*Phaseolus vulgaris L.*  
(Trebisht)



*Juglans regia*  
(Sebisht)



*Phaseolus vulgaris L.*  
(Trebisht)



*Capsicum annuum*  
(Trebisht)



*Phaseolus vulgaris L.*  
(Funarës)



*Cucurbita pepo L.*  
(Orenjë)



*Cucumis sativus L.*  
(Steblevë)